

Ardian Muhaj

**PAVARËSIA E SHTETIT SHQIPTAR DHE ROLI I SHQIPTARËVE NË
KONTEKSTIN RAJONAL PAS SHKËPUTJES NGA PERANDORIA
OSMANE**

**НЕЗАВИСНОСТА НА АЛБАНСКАТА ДРЖАВА И УЛОГАТА НА
АЛБАНЦИТЕ ВО РЕГИОНАЛЕН КОНТЕКСТ ПО
ОДВОЈУВАЊЕТО ОД ОТОМАНСКАТА ИМПЕРИЈА**

**THE INDEPENDENCE OF THE ALBANIAN STATE AND THE ROLE
OF THE ALBANIANS IN THE REGIONAL CONTEXT AFTER THE
SEPARATION FROM THE OTTOMAN EMPIRE**

Përmbledhje

Në këtë punim do të trajtohen pasojat dhe ndikimi i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në zhvillimet politike dhe historike të shqiptarëve, sidomos në kontekstin e ndarjes nga Perandoria Osmane. Pavarësia e vitit 1912 shënoi një kthesë të rëndësishme që ndryshoi jo vetëm kursin historik të kombit shqiptar, por edhe ndikoi në strukturat politike të reja dhe pozicionimin e Shqipërisë në rajon. Kjo periudhë solli sfida dhe transformime themelore në lidhje me pozicionimin e shtetit të ri në kontekstin rajonal e më gjerë.

Do të diskutohet sesi elitat shqiptare, në prag të krijimit të shtetit të ri, vendosën prioritete që konsolidonin identitetin kombëtar dhe synonin ruajtjen e kohezionit politik. Gjithashtu, kumtesa do të analizojë kontekstin rajonal, ku zgjerimi dhe krijimi i shteteve të reja ballkanike pas Luftës së Parë Botërore përforcoi aleancat strategjike dhe ndikoi në sfidat e përbashkëta për shqiptarët dhe rajonin më gjerë.

Qëllimi i kësaj kumtese është të ofrojë një vështrim të thelluar mbi dinamikën e raporteve ndërballkanike dhe ndikimin e shpalljes së pavarësisë në zhvillimin kombëtar dhe organizimin politik të shqiptarëve, si dhe të reflektojë mbi transformimet që përjetoi shoqëria shqiptare fillimet e jetës së pavarur politike.

Konteksti historik dhe faktorët që çuan në pavarësi

Shekulli XIX shënoi një periudhë thelbësore ndryshimesh për shqiptarët dhe Shqipërinë që ndodhej në zemër të transformimeve të mëdha politike dhe gjeopolitike që përfshinë Ballkanin. Ky shekull u karakterizua nga reformat e Tanzimatit të Perandorisë Osmane, lëvizjet kombëtare ballkanike dhe tensionet midis fuqive të mëdha, të cilat ndikuan thellësisht në strukturat sociale, ekonomike dhe kulturore të rajonit. Gjatë shekullit XIX, Ballkani u shndërrua në një hapësirë gjeopolitike ku kryqëzoheshin interesat strategjike të fuqive të mëdha evropiane: Ruisë, Austro-Hungarisë, Britanisë së Madhe dhe më vonë Italisë. Perandoria Osmane, në përpjekje për të ruajtur integritetin territorial të saj, u përball me presione të vazhdueshme që në përgjithësi manifestoheshin nëpërmjet mbështetjes për lëvizjet separatiste ose ndërhyrjeve të drejtpërdrejta ushtarake.

Në këtë sfond të rivaliteteve ndërkombëtare, Shqipëria mori rëndësi të veçantë për shkak të pozicionit të saj gjeostrategjik. Ndryshimet territoriale pas Luftës Ruso-Osmane të viteve 1877-1878 dhe vendimet e Kongresit të Berlinit shënuan një pikë kthese për rajonin. Përfshirja e territoreve shqiptare në planet ndarëse të shteteve sllave, si Serbia dhe Mali i Zi e Bullgaria si edhe Greqisë, mobilizoi reagimin politik dhe ushtarak shqiptar, duke kontribuar në lindjen e Lidhjes së Prizrenit.

Lidhja e Prizrenit, themeluar në vitin 1878, synonte të mbronte tokat shqiptare nga ndarjet e propozuara nga Fuqitë e Mëdha në Kongresin e Berlinit. Një nga qëllimet kryesore të Lidhjes ishte bashkimi i katër vilajeteve me shumicë shqiptare në një njësi administrative të vetme: Shkodra, Kosova, Manastiri dhe Janina. Kjo ide nuk ishte thjesht aspiratë politike, por një mënyrë për të ruajtur unitetin etnik dhe kulturor të shqiptarëve, në kushtet e kërcënimit të këtij uniteti nga shtetet dhe entitetet e reja ballkanike. Veprimtaria e Lidhjes si organizatë politike dhe ushtarake zgjati nga viti 1878 deri në vitin 1881. Roli që ajo luajti në ngritjen e vetëdijes kombëtare me të drejtë mund të quhet “Epoka e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”.

Nën dritën e së drejtës ndërkombëtare, Lidhja nuk i plotësonte të gjitha kushtet për t’u konsideruar një subjekt i plotësuar dhe i pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare. Megjithatë, Lidhja e Prizrenit, përfaqësonte strukturën politiko-ushtarake që ngritën shqiptarët e të gjitha besimeve për të kundërshtuar vendimet e Fuqive të Mëdha dhe frenuar ekspansionin e shteteve fqinjë mbi tokat shqiptare.

Fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX sollën zhvillime të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik. Lëvizjet kombëtare të popujve të rajonit ishin në rritje dhe shumë nga territoret e Perandorisë Osmane në Ballkan kishin nisur rrugën e shkëputjes. Shqiptarët, ndonëse më të vonuar në raport me fqinjët për shkak të kushteve të veçanta historike, sociale dhe administrative, filluan të artikulojnë kërkesat e tyre për autonomi dhe më pas për pavarësi.

Shqiptarët e gjetën veten në një udhëkryq historik. Përmes Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe më pas përmes kryengritjeve të viteve 1910-1912, ata kërkuan jo vetëm autonomi, por edhe ruajtjen e identitetit kombëtar në një rajon të trazuar politikisht. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), Lidhja e Pejës (1899) dhe Kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912 ishin shprehje të qarta të vetëdijes kombëtare dhe të dëshirës për vetëqeverisje. Shqiptarët ende nën sundimin e Perandorisë Osmane, u organizuan në luftë për të fituar pavarësinë, por shtetet fqinjë, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, dhe Greqia, të mbështetura si gjithnjë nga Rusia, qenë ngritur në këmbë. Lëvizjet e tyre antiosmane, synonin territoret shqiptare dhe zhvilloheshin si veprimtari e mirëfilltë antishqiptare.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në Vlorë shënon një moment kyç në historinë moderne të kombit shqiptar. Kjo ngjarje u zhvillua në një kontekst të ndërlikuar rajonal e ndërkombëtar, ku Perandoria Osmane ishte në rënie, ndërsa fuqitë ballkanike dhe ato evropiane përpiqeshin të rishkruanin hartën politike të rajonit sipas interesave të tyre. Pavarësia nuk ishte vetëm një akt simbolik, por ajo përfaqësonte përpjekjen e shqiptarëve për të ndërtuar një shtet kombëtar, për të ruajtur identitetin dhe për të siguruar një vend të barabartë në mesin e kombeve të tjera të Ballkanit.

Në fillimin e shek. XX, ishte momenti historik kur Perandoria Osmane po shkërmoqej, dhe në mes popullsive etnikisht të ndryshme marrëdhëniet që shpesh ishin konfliktuale, u acaruan më shumë. Shqiptarët u organizuan në luftë për të fituar pavarësinë, por shtetet fqinjë që kishin arritur më përpara pavarësinë synonin jo thjesht largimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani por dhe pushtimin e të gjithë territoreve shqiptare. Kërcënimet serbe dhe bullgare në veri e lindje dhe ato greke në jug, përçoheshin nga propaganda të thekshme. Fillimi i Luftërave Ballkanike (1912-1913) e shtynë elitën shqiptare të vepronte shpejt, për të mos lejuar copëtimin e trojeve shqiptare midis shteteve fqinje.

Në këtë atmosferë shqiptarët shpallen pavarësinë në 28 nëntor 1912, në pikën kulmore të Luftës së Parë Ballkanike. Shpallja e

Pavarësisë ishte rezultat i një strategjie politike që synonte të ndalonte copëtimin e trojeve shqiptare nga shtetet fqinje pas fillimit të Luftërave Ballkanike. Ismail Qemali dhe përfaqësues nga krejt trevat shqiptare u mbledhën në Vlorë dhe shpallën Pavarësinë e Shqipërisë. U ngrit flamuri kombëtar dhe u formua një qeveri e përkohshme. Ky akt kishte një rëndësi të jashtëzakonshme politike dhe kombëtare, pasi shënoi lindjen e shtetit shqiptar si një subjekt më vete në skenën ndërkombëtare. Përfaqësuesit e trojeve shqiptare, shpallën e pavarësinë e Shqipërisë jo vetëm nga Perandoria Osmane që po largohej, por edhe nga Greqia e shtetet fqinje sllave që kishin pushtuar tashmë pjesën më të madhe të trojeve shqiptare.

Shpallja e pavarësisë ishte një akt madhor, por nuk ishte i vetmi. Në momentin kur u shpall pavarësia në Vlorë, pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte e pushtuar nga forcat e Aleancës Ballkanike, nga Mitrovica deri në Janinë. Shumë qytete ishin djegur, shumë fshatra ishin shkatërruar, dhe shumë shqiptarë ishin vrarë, masakruar dhe masakroheshin përditë. Malazetët ishin të parët që dolën në fushëbetejë për pushtimin e trojeve shqiptare (8 tetor). Ata i ndanë forcat e tyre në tri ushtri, dy prej të cilave sulmuan Shkodrën, ndërsa e treta pushtoi vilajetin e Kosovës. Dy ushtritë e para u thyen në Shkodër, e cila u mbrojt me vendosmëri. Ushtria e tretë mori Bjellopoljen, Beranen, Plevlen, Plavën, Gucinë dhe Pejën, dhe u bashkua me forcat serbe në Gjakovë. Pas fitores në Kumanovë (24 tetor), ushtritë serbe, pas marrjes së Manastirit, u kthyen drejt veriut dhe pushtuan Prizrenin dhe Gjakovën; më pas, përmes një marshimi të shpejtë nëpër Mirditë, arritën në Lezhë më 19 nëntor. Më tej u kthyen drejt jugut dhe pushtuan Durrësin (30 nëntor), Dibrën, Ohrin dhe Elbasanin. Në jug, ushtria greke pushtoi Korçën, Prevezën dhe më pas rrethoi Janinën. Një flotë greke bombardoi Vlorën më 3 dhjetor, pikërisht në ditën kur u arrit një armëpushim me diktimin e Fuqive të Mëdha, ndonëse rrethimet e Shkodrës në veri dhe të Janinës në jug ende vazhdonin.

Edhe atë ditë, më 28 Nëntor, pati viktima në të gjitha trojet shqiptare. Disa qytete ishin të rrethuara dhe rezistenca e shqiptarëve kundër ushtrive ballkanike vazhonte, duke qenë vendimtare. Shpallja e pavarësisë ishte një akt juridik jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe themelor, sepse, në aspektin e së drejtës ndërkombëtare, përbënte aktin më të rëndësishëm për njohjen e shtetit shqiptar si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, pavarësisht se nuk u njoh menjëherë nga Fuqitë e Mëdha.

Konferenca e Ambasadorëve, e mbledhur në Londër, dha vendimin përfundimtar më 29 korrik 1913, por ky vendim ishte gjysmak, në të gjitha aspektet: gjysmak në aspektin hapësinor, për shkak të përgjysmimit të territoreve shqiptare, por edhe gjysmak në aspektin juridik, sepse nuk u njoh pavarësia e plotë, por autonomia e një principate.

Megjithatë, kufijtë e Shqipërisë së saposhpallur nuk u përcaktuan nga vullneti i popullit shqiptar, por nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, duke lënë jashtë shtetit shqiptar territore të gjera të banuara nga shqiptarë. Në dekadat që pasuan, shqiptarët në rajon — në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Çamëri — luajtën një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kulturor dhe në ndërtimin e marrëdhënieve ndërbalkanike.

Delegatët e të gjitha trojeve shqiptare, në atë ditë madhështore, shpallën pavarësinë e trojeve shqiptare nga Mitrovica deri në Prevezë, ndërsa Konferenca e Londrës, disa muaj më vonë, njohu vetëm pavarësinë e kufizuar të një pjese të këtyre trojeve.

Shpallja e Pavarësisë dhe themelimi i shtetit shqiptar

Konferenca e Ambasadorëve të gjashtë Fuqive të Mëdha, nisë me 17 dhjetor 1912, dhe me vendimet e saj caktoi kufijtë e Shqipërisë së quajtur të 1913-ës. La më shumë se gjysmën e Shqipërisë në duart e sllavëve dhe grekëve. Sfidat ishin të shumta. Kufijtë e shtetit të ri nuk ishin të qarta, pjesë të mëdha të trojeve shqiptare ndodheshin nën pushtimin e shteteve fqinje, dhe fuqitë e mëdha evropiane e shihnin ekzistencën e Shqipërisë si një çështje që duhej balancuar me interesat e tyre strategjike në Ballkan. Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913) njohu pavarësinë e Shqipërisë, por në të njëjtën kohë vendosi një reduktim të ndjeshëm të territorit të saj historik.

Në 8 gusht 1913, Konferenca e Londrës, në mbledhjen e ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, përcaktoi kufirin midis Greqisë dhe Shqipërisë, duke urdhëruar që Greqia të lironte viset e pushtuara të Shqipërisë. Greqia u përgjigj se do t'i lironte gradualisht, por kërkonte të bëhej një rregullim i kufijve në favor të saj. Pasi u arrit kompromisi mbi caktimin e kufirit të jugut të Shqipërisë, më 17 dhjetor 1913 në Firencë u nënshkrua Protokollin e Firences. Fuqitë e Mëdha, më 13 shkurt 1914 i deklaruan qeverisë greke se më 1 mars duhej të fillonte tërheqjen nga Korça dhe më 31 mars ta përfundonte zbrazjen e gjithë Shqipërisë.

Në janar 1914 qeveria e përkohshme e udhëhequr nga Ismail Qemali u detyrua të jepte dorëheqjen, ndërsa pushteti i kaloi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit mori masa të shpejta për të organizuar xhandarmërinë shqiptare. Për këtë qëllim në Shqipëri erdhi një mision ushtarak holandez nën kryesinë e kolonelit De Veer dhe majorit Tomson, etj. Në bashkëpunim me oficerët shqiptarë, ata organizuan xhandarmërinë për viset e lira.

Ndërkohë fillimi I Luftës së Parë Botërore solli një dinamikë të shtuar ngjarjesh dhe ndryshimesh politike e gjeopolitike. Më 27 tetor 1914, qeveria greke shpalli zyrtarisht pushtimin e Shqipërisë së Jugut. Po ashtu në fund të tetorit 1914, Italia zbarkoi në Vlorë një “mision sanitar” i cili në të vërtetë do të përgatiste terrenin për pushtimin ushtarak.

Momenti më i vështirë në aspektin gjeopolitik që rrezikonte ekzistencën e vetë shtetit të cinguar të njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në 1913 ishte Traktati i Fshehtë të Londrës, nënshkruar më 26 Prill 1915. Ky traktat që parashikonte ndarjen e shtetit shqiptar në mes fqinjëve adriatikë e ballkanikë u shoqërua me zhbërjen e aleancës mes Italisë dhe Austro-Hungarisë. Duke qenë se këto dy shtete jashtëballkanike kishin qenë jo vetëm balancues dhe frenues të orekseve të fqinjëve ballkanikë kundrejt Shqipërisë prishja e aleancës dhe më pas përfshirja në luftë midis tyre do të kishte pasoja të rënda për Shqipërinë. Ky traktat, ishte një marrëveshje e fshehtë e përfunduar midis fuqive të Antantës dhe qeverisë italiane për të plotësuar pretendimet e imperializmit italian në Shqipëri dhe lakmitë ekspansioniste të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Sipas pikës 5 të Traktatit bregdeti shqiptar prej derdhjes së Bunës në veri deri në derdhjen e Drinit në jug, përfshirë Shëngjinin, do t'i kalonte Serbisë dhe Malit të Zi. Sipas pikës 6 Vloza dhe ishulli i Sazanit i kalonte Italisë. Sipas pikës 7 Italia detyrohej të mos e kundërshtonte dëshirën eventuale të Francës, Anglisë dhe Ruisë që pjesët veriore e jugore të Shqipërisë të ndaheshin midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, ndërsa në Shqipërinë e Mesme do të formohej shteti shqiptar “autonom”, i cili do të ishte nën protektoratin e Italisë. Traktati u hodh poshtë më vonë nga Kongresi i Lushnjës.

Qeveria e Princ Vidit nuk kishte arritur të legjitimojë veten ndërkombëtarisht dhe as të arrijë përkrahjen e shtresave të ndryshme të popullsisë shqiptare. Në tryezat diplomatike princ Vidi ishte dukur si përzgjedhja më e mirë për fronin e Shqipërisë, mirëpo në realitetin politik e social të Shqipërisë së kohës ky perceptim shkoi duke ndryshuar. Princi nuk ia doli të dominonte situatën qoftë në rrafshin e

brendshëm qoftë në atë të jashtëm sidomos në përballje me orekset territoriale e politike të fqinjëve të Shqipërisë. Ambasadori i Gjermanisë në Durrës më 30 qershor 1914, duke analizuar gjendjen në Shqipëri arrinte në përfundimin se Princ Vidi nuk kishte mbështetjen e mjaftueshme në popullsinë e Shqipërisë.

Goditja më e rëndë ndaj sovranitetit të vetë Princit ishte nënshkrimi poshtërues i Protokollit të Korfuzit. Pas nënshkrimit të protokollit të Korfuzit, Greqia e thelloi edhe më tej ndërhyrjen dhe cenimin e integritetit dhe sovranitetit të shtetit shqiptar duke ndërmarrë operacione ushtarake që rezultuan në masakrimin e popullsisë shqiptare në pjesën jugore të Shqipërisë. Një nga tragjeditë më të mëdha që përjetoi Shqipëria në këto vite megjithatë nuk i erdhi nga ushtritë ndërluftuese, por nga bandat e organizuara nga shtetit grek, sidomos nën maskën e të ashtuquajturës “lëvizje epirote”. Kjo lëvizje antishqiptare u organizua nga qeveria greke më 1914 me përkrahjen e pak elementeve renegatë shqiptarë dhe u zhvillua në krahinat e Korçës, Kolonjës, Leskovikut, Përmetit e Gjirokastrës. Me luftëra të përgjakshme, zjarr e masakra, shkatërroi shumë vende e fshatra në ato krahina. Egërsia e andartëve (banditëve) grekë kundër popullsisë myslimane të atyre krahinave sidomos në Leskovic, Kolonjë, Përmet e në Çamëri ka qenë veçanërisht e madhe. Ata vrisnin njerëzit pa dallim dhe digjnin me radhë fshatrat.

Në korrik 1914, ushtria dhe bandat greke kishin avancuar në gjithë vijën nga Përmeti në Korçë, duke djegur të gjitha fshatrat myslimane, ndërsa popullsia e terrorizuar largohej për në veri. Oficerët shqiptarë e holandezë ishin tërhequr drejt Vlorës. Sipas Teki Selenicës, Korça ra edhe një herë nën sundimin grek, ku me mijëra njerëz të katundeve të Korçës, të Kolonjës, të Skraparit u larguan drejt Beratit dhe Vlorës. Banda ushtarësh zyrtarë të veshur si andartë “kishin ndezur zjarrin e flakën mbi gjithë vijën e kufisë prej ku lartësohesh në qiell tymi e flaka e katundeve shqiptare që, si plaçkiteshin, digjeshin”.

Ndërhyrja greke solli reagimin e qytetarëve dhe patriotëve shqiptarë, të cilët në mënyrë të vetëorganizuar, por edhe duke kërkuar me këmbëngulje mbështetjen e qeverisë së Vidit u vunë përballë avancimit të mëtejshëm grek në Shqipëri. Përveç reagimit popullor agresioni grek ndaj Shqipërisë vuri në lëvizje diplomacinë dhe [politikën italiane që do të vendoste ndërhyrjen ushtarake në Shqipëri me qëllim për të ndaluar avancimin e forcave greke në sferën e tyre të interesit. Në 25 dhjetor 1914 Italia zbarkoi në Vlorë një mision humanitar, natyrisht të mbrojtur dhe të shoqërua nga forca të mjaftueshme ushtarake për të përballuar

shtrirjen e forcave greke drejt bregdetit adriatik të Shqipërisë. Pas hyrjes në luftë përkrah Antantës dhe kundër Austrisë, Italia vendosi shndërrimin e misionit të deklaruar humanitar në një zbarkim të mirëfilltë ushtarak nën komandën e gjeneralit Bertotti. Trupat italiane më 28 nëntor 1915 zbarkuan në Vlorë e gradualisht e shtrinë aksionin e tyre drejt veriut, deri sa më 5 dhjetor pushtuan Durrësin. Megjithatë, avancimi i shpejtë i Austrisë nga Veriu drejt Durrësit e detyroi Italinë të braktiste Durrësin më 26 shkurt 1916 duke e përqendruar forcën e vet ushtarake në mbrojtje të bazës detare të Vlorës. Forcat italiane nuk vonuan për të marrë nën kontroll zona të tjera në jug të Shqipërisë. Kështu, në vjeshtën e vitit 1916 mori Tepelenën, Gjirokastrën, Sarandën, Delvinën, Jergucatin, Peshkopinë, Përmetin dhe në shkurt 1917, Ersekën.

Duke qenë se interesat greke dhe Italiane përplaseshin haptazi në jug të Shqipërisë, diplomacia italiane u përpoq de ia doli të dominojë këtë përplasje duke e mveshur praninë e vet ushtarake me objektivin e rindërtimit dhe zhvillimit të zonës nën pushtimin e saj si edhe me lehtësimin e situatës humanitare në këtë zonë. Në këtë pikë natyrisht Greqia ishte e humbur përballë Italisë, sepse masakrat dhe shkatërrimet e kryera nga Greqia në jug të Shqipërisë ishin të dukshme dhe të dokumentuara detajisht. Gjithashtu, Italia e bëri të qartë me politikën e saj se prania e saj ushtarake në Shqipëri ishte kundër çdo spastrimi etnik dhe fetar, gjë të cilën Greqia e kishte bërë motiv kryesor të agresionit të saj ndaj Shqipërisë.

Me hyrjen e SHBA në luftën botërore (1917), politika e qeverisë italiane ndryshoi. Më 3 qershor 1917, në Gjirokastrë, gjenerali Giacinto Ferrero, i shoqëruar nga oficerë e autoritetet italiane dhe shqiptare, nën himnin kombëtar shqiptar, kënduar nga nxënësit e shkollave, lexoi proklamatin që shpallte pavarësinë e Shqipërisë, të garantuar nga Italia.⁵⁶⁶ duke e hedhur poshtë Traktatin e 26 Prillit 1915.

Nga ana tjetër, në maj 1913, forcat ndërkombëtare hynë në Shkodër, pas largimit të ushtrisë së Malit të Zi. Që nga fillimi i majit 1913, kur u larguan forcat e Malit të Zi, në Shkodër u vendosën forcat ndërkombëtare dhe për vite me radhë zona e Shkodrës do të administrohej prej tyre. Në mars 1914, kur Princ Vidi erdhi në Shqipëri dhe u krijua qeveria e tij, Fuqitë e Mëdha nuk e përfshinë Shkodrën nën autoritetin e qeverisë së tij, por faktikisht e lanë si një lloj kantoni brenda shtetit shqiptar që ato krijuan më 1913. Me fillimin e luftës së madhe evropiane, forcat ndërkombëtare në Shkodër u larguan, e në qytet mbetën vetëm forcat italiane. Më 1915, Shkodra u pushtua nga forcat austro-

hungareze nën komandën e gjeneralit Trolmon. Sapo erdhi në Shkodër, me titullin e Komisarit Civil, Kral zgjodhi administratën e bashkisë dhe emëroi kryetar Musa Jukën, ndërsa komisar civil bashkëpunëtor, emëroi majorin Hauf Mantase. Fejzi Alizoti u emërua drejtor i Financës, ndërsa Luigj Gurakuqi drejtor i përgjithshëm i arsimit publik. Kur u larguan austriakët, Shkodra u pushtua nga francezët. Administrata u formua përsëri në shumicë nga nëpunësit e mëparshëm. Si komisar civil u emërua një inxhinier francez me banim në Shkodër, ing. Briot.

Po kështu, në maj 1914, kur Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit bëri marrëveshje me qeverinë “autonome” të Jorgji Zografos, në atë që njihet si Protokolli i Korfuzit. Deri në 1916, zona e rajonit të Gjirokastrës pati formën e një kantoni, dhe po të njëjtën formë pati edhe “Republika autonome” e Korçës. Në qeverinë e Princ Vidit, kryesuar nga Turhan pashë Përmeti, Esad Toptani u emërua ministër Brendshëm dhe i Luftës. Gazeta “Taraboshi”, në numrin e 29-30 marsit 1914, shkruante se gjeneral Esad Toptani kishte mosmarrëveshje me kolonelin Thomson, i cili thoshte që Zografos-i të emërohej kryesundues i Gjirokastrës.

Përmbledhtazi, mund të theksohet se në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913, shtetet kryesore evropiane vendosën të njihnin shtetin shqiptar të deklaruar të pavarur në Kuvendin e Vlorës më 28 nëntor 1912. Përveç njohja e pavarësisë së Shqipërisë u bë në një territor që zinte më pak se gjysmën e trojeve ku banonin shqiptarët, shtetit shqiptar iu caktua edhe vendosja e një princi si udhëheqës i shtetit të sapoformuar. Në mesin e kandidatëve të shumtë u zgjodh si princ i Shqipërisë, Vilhelm von Vid dhe për t’i hapur rrugë vendosjes së Princit në Shqipëri u kërkua po nga Fuqitë e Mëdha që të dy qeveritë që rivalizonin në Shqipëri, ajo e Durrësit nën drejtimin e Esat Toptanit dhe ajo e Vlorës nën drejtimin e Ismail Qemal Vlorës duhet të zhbëheshin dhe drejtuesit e tyre të jepnin dorëheqjen dhe të shpallnin zhbërjen e tyre. Mirëpo, ndërkohë që dy udhëheqësit shqiptarë të qeverive të Durrësit dhe Vlorës e pranuan këtë, Fuqitë e Mëdha nuk e vazhduan presionin edhe përtej shtrirjes së këtyre qeverive, për të vënë nën autoritetin e qeverisë së Princ Vidit krejt sipërfaqen e shtetit të njohur prej tyre dhe as krejt popullsinë nën sovranitetin e ligjshëm të Princit. Madje, çuditërisht edhe pse Shkodra ishte nën sundimin e forcave ndërkombëtare të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit që prej majit të vitit 1913, nuk tentuan ta përfshinin nën sovranitetin e Princ Vidit. Kësaj i shtohet fakti që jashtë autoritetit të qeverisë së Vidit mbetën zonat malore dhe jugu i Shqipërisë me përjashtim të Vlorës. Vetëm

zona e Shqipërisë së Mesme dhe disa zona përreth si dhe Vlora u përfshinë nën administrimin e qeverisë së ligjshme dhe mbanin me taksa administratën e qeverisë.

Organizimi i shtetit të ri

Pas shpalljes së pavarësisë, shqiptarët u përballën me nevojën për të ndërtuar një shtet funksional dhe për të ruajtur identitetin e tyre në një rajon të trazuar jo vetëm nga përballjet ballkanike por edhe nga ato mes shteteve evropiane. Pavarësisht dobësive dhe vështirësive të fillimit të shtetformimit Shqipëria u bë një element i rëndësishëm në ekuilibrat ballkanikë, jo vetëm për shkak të pozicionit të saj gjeostrategjik, por edhe për shkak të peshës së shqiptarëve në territoret e mbetura jashtë shtetit shqiptar si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Çamëria. Në këtë mënyrë, shqiptarët u shndërruan në faktorë të stabilitetit në Ballkan, pavarësisht sfidave dhe shpeshherë përjashtimit nga vendimarrja politike në ato vende.

Shpallja e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912 shënon një nga momentet më kyçe në historinë kombëtare të Shqipërisë. Ky akt nuk ishte vetëm finalizimi i një lëvizjeje të gjatë kombëtare, por edhe pika fillestare e transformimit të thellë shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit. Ndërsa shqiptarët u përballën me sfida të shumta në krijimin e institucioneve kombëtare, ky proces u përshkua nga ndërhyrje të jashtme, konflikte të brendshme dhe nevoja urgjente për zhvillim.

Ismail Qemali dhe kabineti i tij u përpoqën të krijonin një administratë qendrore të qëndrueshme në një territor të copëtuar nga interesat rajonale dhe nën trysinë e fuqive të mëdha. Vendosja e kufijve të Shqipërisë nga Konferenca e Londrës më 1913 la jashtë territore të konsiderueshme shqiptare, duke krijuar tensione që ndikuan në kohezionin kombëtar.

Në këtë kontekst, u themeluan disa institucione bazë për të garantuar funksionimin e shtetit, siç ishin Këshilli i Ministrave, administrata financiare dhe gjyqësore. Megjithatë, mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara dhe rivalitetet midis grupeve të ndryshme e vështirësuan procesin e ndërtimit të një qeverisjeje të qëndrueshme. Përpjekjet për unifikimin e legjislacionit dhe centralizimin e pushtetit hasën rezistencë nga strukturat tradicionale lokale.

Shoqëria shqiptare pas pavarësisë ndodhej në një fazë tranzicioni nga strukturat tradicionale drejt modernizimit, por gjithashtu lindën

nisma për reformë arsimore dhe kulturore. Hapja e shkollave shqipe dhe promovimi i gjuhës kombëtare ishin thelbësore për forcimin e identitetit të përbashkët shtetëror.

Reformat arsimore nisën me hapjen e shkollave fillore dhe të mesme, ku theksi vihej në mësimdhënien në gjuhën shqipe. U botuan libra dhe fletore për të edukuar brezin e ri me një ndjenjë të fortë kombëtare. Gjithashtu, u ndërморën përpjekje për të krijuar një elitë intelektuale që do të udhëhiqte procesin e modernizimit.

Ekonomia shqiptare në fillim të shekullit XX ishte kryesisht bujqësore dhe me pak industri të zhvilluar. Pas shpalljes së pavarësisë, nevoja për reforma ekonomike ishte e madhe. Megjithatë, mungesa e burimeve financiare dhe infrastruktura e dobët përbënin pengesa serioze për zhvillimin. Investimet e huaja filluan të paraqiteshin si mundësi, por shpesh shoqëroheshin me ndërhyrje politike.

Përpjekjet për modernizimin ekonomik përfshinë disa reforma në bujqësi, si ndarja dhe shpërndarja më efektive e tokës. Megjithatë, proceset ishin të ngadalta dhe të fragmentuara për shkak të mungesës së stabilitetit politik. Ndërtimi i rrugëve dhe hekurudhave nisi të shihej si një hap i rëndësishëm për zhvillimin e tregtisë dhe lidhjen më të mirë të rajoneve, por këto projekte mbetën të kufizuara për shkak të fondeve të pamjaftueshme.

Industria, ndonëse në nivele fillestare, filloi të zhvillohej me hapjen e disa punishteve dhe uzinave të vogla, kryesisht në përpunimin e materialeve bazë. Megjithatë, zhvillimi industrial kërkonte investime të mëdha dhe teknologji moderne, që shpesh mungonin në një ekonomi të dobët dhe të izoluar.

Shqipëria pas shpalljes së pavarësisë ndodhej në një pozicion tepër të ndjeshëm gjeopolitik. Fuqitë e mëdha evropiane, si Austro-Hungaria, Italia, dhe Rusia, patën interesa të kundërta për rolin dhe ndikimin e tyre në Ballkan, dhe Shqipëria shpesh u pa si një territor strategjik për planet e tyre.

Goditja më e rëndë që iu dha përpjekjes dhe procesit të organizimit të shtetit të sapoformuar shqiptar ishte fillimi i Luftës së Parë Botërore, vetëm një vit pas njohjes së Shqipërisë nga Konferenca e Albasadorëve. Një vit jetë politike, ishte shumë pak për mbarëvajtjen e themelimit të një shteti. Pas luftërave ballkanike të viteve 1912 dhe 1913, Lufta e Parë Botërore po ashtu do kalojë dramën e saj të madhe mbi shqiptarët.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u kthye në fushëbetejë ndërmjet ushtrive të huaja. Italia, Austro-Hungaria, dhe fuqitë e tjera u përpoqën të vendosnin kontrollin mbi territoret shqiptare, duke lënë vendin në një gjendje kaosi dhe pasigurie. Përsëri dhuna e ushtrive sllave dhe greke do shkaktojë tmerre dhe shpërngulje të tjera. Qe një grusht i papritur kundër popullit shqiptar me pasoja të rënda kombëtare të përmasave historike. Nën tmerrin e pushtimit të huaj shumë familje shqiptare nga shumë vise lanë vatrat e tyre.

Në vitet 1918-1920, Shqipëria gjendej në një situatë të brishtë politike dhe ushtarake. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, vendi ishte i rrezikuar nga pretendimet territoriale të fqinjëve dhe nga mungesa e një qeverisjeje të qëndrueshme. Konferenca e Paqes në Paris (1919) po shqyrtonte fatin e kufijve të Shqipërisë, ndërsa fqinjët, kishin synime për ta copëtuar vendin. Në këtë kontekst, patriotët shqiptarë u mobilizuan për të mbrojtur kufijtë e vendit dhe sovranitetin e tij. Kjo fazë mund të thuhet se u përmbyll në fund të vitit 1920 kur Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve.

Bibliografia:

1. Abdyli, Ramiz, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Burimet Angleze. (Lufta shqiptaro-malazeze gjatë periudhës mars-korrik 1880)*, Libri I, Prishtinë, 2004.
2. Anamali, Skënder, red. *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
3. Berri, Gino. *L'assedio di Scutari. Sei mesi dentro la citta accer chiata (Diario di un corrispondente di guerra)*. Milano, Fratelli Treves, 1913.
4. Clayer, Nathalie, *Une histoire en travelling de l'Albanie (1920-1939). Avec, au-delà et en-deçà de l'État*. Paris, Karthala, 2022
5. Dauti, Daut, *Britania dhe Çështja Shqiptare Gjatë Rënies së Perandorisë Otomane 1876-1914*, Shkup Prishtinë, Tiranë: Logos A, 2020.
6. Drini, Genc, Ardian Muhaj, *Një jetë për shqiptarinë. Riza Drini. Atdhetari, politikani, nacionalisti*, Ars & Academic Publishing, Tiranë, 2022.
7. Elsie, Robert. *Historical Dictionary of Albania*. Lanham, MD: Scarecrow Press, 2010.

8. Fischer, Bernd Jürgen. *Albania at War, 1939-1945*. West Lafayette, IN: Purdue University Press, 1999.
9. Gawrych, George. *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874–1913*. London: I.B. Tauris, 2006.
10. *Historia e Popullit Shqiptar*, Vol. II, (Grup autorësh), Tiranë: Toena, 2002.
11. Judah, Tim. *Kosovo: SWar and Revenge*. Neë Haven, Connecticut: Yale University Press, 2002.
12. Malcolm, Noel. *Kosovo: A Short History*. London: Macmillan, 1998.
13. Mc Carthy, Justin, *Vdekje dhe Dëbim*, botim shqip, Tiranë 2006.
14. Prifti, Kristaq, red. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 1912*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2008.
15. Pulaha, Selami, Stefanaq Pollo, *Akte të Rilindjes Kombëtare 1878-1912*, Tiranë, 1978.
16. Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912–1914*. Tiranë, 1978.
17. Puto, Arben, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, Tiranë: Dudaj, 2010.
18. Rizaj, Gazmend S. *Shqipëria e Sipërme 1800-1913. Në projektet dhe traktatet e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike*; Instituti Albanologjik, Prishtinë 2011.
19. Sadiku, Xhafer, *Fuqitë e mëdha në formimin e shtetit shqiptar*, Ars & Academic Publishing, Tiranë, 2023.
20. Schmitt, Oliver Jens. *Kosova: Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Përkth. Ardian Klosi. Pejë: Dukagjini, 2012.
21. Vickers, Miranda. *The Albanians: A Modern History*. London: I.B. Tauris, 1995.
22. Vllamasi, Sejfi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942): kujtime dhe vlerësime historike*, Tiranë, 1995.